



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1 prot.

Himarë, më 16.02. 2026

ZBARDHJE E PROTOKOLLIT NGA ORGJINALI I MBLEDHJES TË RADHES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË.

Sot më datë 16.02.2026 zhvillohet mbledhja e radhës kërkuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak. Hapet mbledhja në orën 11:00.

Të ftuar kryetari Bashkisë, nënkryetarët e Bashkisë, drejtoritë, administratorët e njësive, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët :

Dhimitër Kapaj, Lenica Kocani, Elisabeta Lamaj, Aleks Llazari , Mirka Gjiçali, Timoleo Gërdhuqi, Gjergji Iliadhi, Milto Nika, Afrovita Dhimojani, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Qirjako Mërkuri, Artan Bala, Theodhori Foto, Nikolin Laska, Silva Burbo, Ervis Caushaj.

Plotësohet kuorumi me 17 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Hap mbledhjen kryetari i këshillit.

Fillon rendi i ditës sipas njoftimit.

Sqaron Kryetari i Këshillit për një vendim të marrë nga KB në muajin Qershor për një kompani ndërtimi dhe rishikuar sërish në Tetor 2025 dhe nuk ka kaluar në votim.

Rendi i ditës u diskutua nga Kryesia e KB në orën 10:00 përpara mbledhjes dhe u vendos që pikat 1,3,4,6 të hiqen nga rendi i ditës për arsye se nuk janë mbledhur komisionet përkatëse, sipas nenit 33-34 të rregullores së KB Himarë.

Pika e Dytë : Flet Kryetari i Komisionit Milto Nika për çfarë u diskutua në komision dhe komisioni ka vendosur që ky Projektvendim t'i kalojë Këshillit për votim, pasi është dakordësuar në këtë komision.

Merr fjalën anëtarja e komisionit Silvana Burbo për sqarim nga një hartograf për zonën kadastrale të këtij projektvendimi.

Sqaron Kryetari i Bashkisë këtë projektvendim për transferimin e kësaj prone në varësi të MEI (Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit).

Sqaron Këshilltari Gërdhuqi për këtë projektvendim.

Këshilltari Iliadhi kërkon informacion shtesë mbi këtë projektvendim.

Sqaron Drejtoria Juridike për të gjithë këshilltarët për paqartësitë që kanë.

Kalon për votim ky projektvendim. 15 PRO, 2 KUNDËR, 0 ABSTENIM

Pika e Pestë: Ndihma ekonomike.

Kalojnë për votim 2 projektvendimet e ndihmës ekonomike.

17 PRO, 0 KUNDËR, 0 ABSTENIM

Shqyrtohen kërkesa të ndryshme të qytetarëve dhe organizatave.

- Merr sqarim kryetari i shoqatës Bregdeti Nivicë-Bubar Gentian Papagjika.
- Zonja Hajrie Tartaraj, banuese në fshatin Bolen, është parashikuar këtë vit për t'ju restauruar banesa sipas drejtorisë përkatëse dhe procedurave të bashkisë Himarë.

Mbyllet mbledhja e Këshillit Bashkiak, ora 12:30.

Sekretari : Zaho Dedi